

ABSTRAKTI

Ky punim masteri shqyrton ndikimin e strehimit familjar në mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror. Strehimi familjar është një praktikë e rëndësishme që ofron mbrojtje dhe kujdes për fëmijët pa kujdes prindëror, duke i ndihmuar ata të gjejnë një ambient të sigurt dhe të ngrohtë.

Në një kontekst ku shumë fëmijë përballen me mungesë të mbështetjes dhe kujdesit adekuat, është thelbësore të analizohen modelet e strehimit dhe roli i tyre në sigurimin e mirëqenies së fëmijëve. Punimi paraqet një shqyrtim të thellë të politikave sociale, praktikave aktuale dhe sfidave që lidhen me strehimin e fëmijëve në situata krizash.

Gjithashtu, do të analizohet roli i institucioneve në garantimin e cilësisë së kujdesit dhe si shoqëria mund të kontribuojë në krijimin e një ambienti mbështetës për fëmijët e kësaj kategorie. Duke u fokusuar në sfidat dhe mundësitë që ofron ky sistem, studimi synon të kontribuojë në përmirësimin e politikave të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror dhe të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e strehimit familjar.

Ky punim sadopak kontribuon në kuptimin e rëndësisë së strehimit të sigurt si një element kyç për mirëqenien e fëmijëve

Fjalë kyçe: Strehimi familjar, fëmijë, kujdes prindëror